



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINETI PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>2708</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>42</u>		
Data/Datum/Date <u>14/ 9/ 22</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023

Shtator, 2022

Hyrje

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit ka prezentuar projekt buxhetin për vitin 2023-2025:

Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2023, në total prej 17,548,248.00 euro, ku ky buxhet është ndarë në kategori, si:

1. Paga dhe Meditje, në shumë prej 8,453,000.00 euro;
2. Mallëra dhe Shërbime në shumë prej 2,203,000.00 euro;
3. Shpenzime Komunale, në shumë prej 370,000.00 euro;
4. Subvencione dhe transfere në shumë prej 820,000.00 euro;
5. Investime Kapitale në shumë prej 5,701.000.00 euro

Krasuar me vitin 2022 kemi rritje të buxhetit prej 2,494,580.00 euro.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023

Kryetari i Komunës, më 28 korrik ka marrë vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025

Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025, në këtë përbërje:

1. Ekrem Bytyqi – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kryesues
2. Qëndresa Kryeziu – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, anëtare
3. Ardian Rama – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
4. Antigona Krasniqi – Drejtoria për Arsim, anëtare
5. Blerta Gashi – Zyrtare për Informim, anëtare
6. Muharem Morina – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
7. Albulena Rexha – Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtare

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025, të bëj hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëj përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëj hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike, të bëj hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatit për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime rreshtazi, duke bërë Planin e veprimit për degjimet buxhetore, përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim.

Plani i veprimit ka përfshirë organizimin e dëgjimeve publike nga ekzekutivi gjatë periudhës korrik-gusht, si dhe organizimin e dëgjimeve buxhetore nga Kuvendi Komunal përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa, 12 dhe 14 shtator.

Ekzekutivi komunal ka organizuar gjithsej katër dëgjime publike buxhetore. Njoftimi, kalendari, Plani i veprimit dhe një dokument i detajuar mbi buxhetin janë publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit, në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, në rrjete sociale, janë dërguar ftesa përmes rrjeteve sociale, e-maileve dhe direkt përmes thirrjeve telefonike, duke i ftuar pjesëmarrësit që të bëhen pjesë direkte e përgatitjes së buxhetit.

Publikimi u me kohë më 1 gusht 2022, ashtu siç parasheh Udhëzimi për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike:

Njoftimi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-PER-DEGJIM-PUBLIK-ME-OIQ.pdf>

Kalendari: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf>

Plani i Veprimit: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/PLANI-I-VEPRIMIT-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf>

Dokumenti i specifikuar i buxhetit: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/PREZENTIMI-I-BUXHETIT-2023.pdf>

Platforma Qeveritare për Konsultime Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/meetings.php?InstitutionID=20529&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Dëgjimet publike buxhetore

Procesi i dëgjimeve buxhetore filloi më 15 gusht deri më 18 gusht 2022, me gjithsej 4 dëgjime publike, në të cilat qytetarët dhe grupet e interesit patën mundësi të paraqesin kërkesat dhe sugjerimet për një buxhetim sa më gjithëpërfshirës.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me me Organizatat Joqeveritare që veprojnë në komunën e Rahovecit	15.08.2022 1 orë	29 pjesëmarrës 6 femra	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
2. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit Me bizneset dhe grupet e interes	16.08.2022 40 minuta	10 pjesëmarrës 3 femra	1 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesë
3. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit Buxhetimi Gjinnor	17.08.2022 40 minuta	27 pjesëmarrës 20 femra	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

4. Takim i drejtpërdrejtë në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj"-Rahovec me bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rinisë	18.08.2022 40 minuta	30 pjesëmarrës 1 femër	15 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	14 ditë para dëgjimit publik		Asnjë koment nuk kemi marrë

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2023, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më 1 shtator 2022 do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e Dëgjimit Buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / kërkesë / sygjërim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti i vitit 2023 Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me me Organizatat Joqeveritare që veprojnë në komunën e Rahovecit	1. Kërkesë për ndërtimin e Tribunës për KF "Xërxa"	Daut Kryeziu, nga KF "Xërxa" – Xërxë	1.I pranuar	1. Është futur në buxhet në kuadër të projekteve të DKRS
	2. Fushë sintetike për ushtrimin e lojtarëve		2.I pranuar pjesërisht	2.Në konsultim me DKRS do të shohim gjatë vitit.
	1. Mungesë e ambientit të OJQ-së Bajram Curri	Fatmir Sejfullahu, OJQ Bajram Curri	1.I pranuar	1. Eshte futur në buxhet në kuadër të projekteve të DKRS
	2. Rritja e përkrahjes (subvencionim) për OJQ-n Bajram Curri		2.I pranuar	2.Komuna e Rahovecit ka përkrahur dhe subvencionuar vazhdimisht OJQ-të, njëjtë do të vazhdohet edhe gjatë vitit që vjen kur dihet që është rritur kodi i subvencioneve.
	1 Stadiumit në Dejnë t'i mundësohet një ambient zhyeshore dhe një zyrë për administratën e Klubit.	Xhafer Bytyqi- KF Anadrini	1. I pranuar pjesërisht	Komuna e Rahovecit ka bërë vazhdimisht trajtimin adekuat të klubeve dhe OJQ sportive, do të bëjmë përpjekje që edhe Stadiumit në Dejn t'i mundësohet një zhyeshore në kuadër të planifikimit 2023-2025

	1. Ndërtimi i teatrit të Qytetit (teatri amator)	Shkumbim Kryeziu- SHL Kosova	1. I pranuar	Komuna e Rahovecit është e gatshme që në bashkëpunim me SHL "Kosova" të formoj teatrin amator.
	1. Shtëpia private e familjes Mullabazi të kthehet në shtëpi Muze, sepse gjatë kohës Luftës ka qenë si shtabi i UÇK-së	Admir Mullabazi-KH"Halit Hoxha"	1. I pranuar pjesërisht	DKRS në bashkëpunim me OVL të UÇK-së do të bëjë përpjekje që në Planin vjetor të OVL-së të futet dhe kjo shtëpi muze.
Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me Bizneset	1. Sheshi qendror i qytetit (a është përfshirë ky projekt në buxhetin për vitin 2023	Besmire Bytyçi, qytetare	1. I pranuar	1. Janë bërë hapjet e ofertave në muajin shtator dhe pas vlerësimit të ofertave pritet të shpallet fituesi për ekzekutimin e punimeve në shesh.
Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit Buxhetimi Gjnor	1. Lirimi i trotuarëve nga veturat	Besmire Bytyçi, qytetare	1. I pranuar	1. Përveç inspektoriatit komunal që ka për detyrë të përcjell uzurpimin e trotuareve poashtu është kompetence e policisë të liroj trotualet
	2. Ndriçimi publik në qytet		2. I pranuar	3. Përveç ndriçimit publik i cili është në qytet pritet poashtu të përfundoj deri në fund të vitit në të

eDëgjim publik në Shtëpinë e	1. Kërkesa për zyrën për barazi gjinore, që në kuadër të kësaj zyre të rritet buxheti për këtë zyre.	Habibe Haxhimustafa, zyrtare	1. I pranuar	gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. 1.Buxheti është I planifikuar për çdo vit
	1. Rritja e buxhetit shtesë për personat me nevoja të veçanta.	Blerina Hajda, OJQ Hareja	1. I pranuar	1.Kemi rritje të buxhetit në kuadër të subvencioneve. Vazhdimisht komuna e Rahovecit subvencionon OJQ me theks të veçantë OJQ që merren me persona të hendikepuar. Poashtu komuna e Rahovecit ka bërë investime në infrastrukturë publike, në uljen e platformave të trotuarit për lehtësim të lirë të levizjes. Jane diku 55 platforma vetëm në qytet dhe institucione publike
	1. Aparaturë për kryerjen e analizave të PAP testit.	Melinda Oruçi Iska	1. I pranuar	1.Kërkesa do të planifikohet për vitin 2023
	1. Hapja e rrugës në mes të dy varrezave në Lagjen e Epërme	Sahadete Dula qytetare	1. I pranuar	1.Do të intervenohet vitin 2023, do të rishikohet mundësia për hapjen e rrugës mes dy varrezave, paraprakisht duke marrë pëlqim nga bashkësitë fetare për hapjen e kësaj rruge.
	1. Rregullimi i shtratit të	Besnik Popaj - Fortesë	1. I pranuar	1.Jane duke vazhduar punimet ne dy segmente në trajtimin e ujërave atmosferik që lidh

K ulturës M ensur Z beraj"- R ahovec m bashkësitë I ole dhe I agjet urbane, m p ëfaqësues të s hollave dhe r inë	lumit në Fortesë			fshatin Fortesë dhe qytetin e Rahovecit
	1. Mungesë e palestres. 2. Mungesë e stadimit për KF Bashkimin.	Fatmir Sejfullahu- Krushë e Madhe	1.I pa pranuar 2.I pa pranuar	1.Është kompetencë e MKRS. Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka bërë kërkesa në MKRS. Ka patur dhe memorandume bashkepunime mes Komunës dhe Ministrisë, në ndërkohë MKRS ka hequr nga buxheti këto dy projekte
	1. Mungesë e Palestrës 2. Rregullimi i rrugës së Drinit. 3. Përfundimi i sheshit dhe kubëza. 4. Nevoj për shtëpi muze për Bajram Currin	Sejfullah Sejfullahu- Krushë e Madhe	1.I papranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4.I pranuar pjesërisht	1. Është kompetencë e MKRS. Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka bërë kërkesa në MKRS. Ka patur dhe memorandume bashkepunime mes Komunës dhe Ministrisë, në ndërkohë MKRS ka hequr nga buxheti këto dy projekte 2. Ne vitin 2023 në kuadër të buxhetit nga Granti i performancës është ndarë buxhet i veçantë për trajtimin e rrugëve të zonave me karakter biznesi, duke përfshirë edhe rrugën e Drinit. 3. Projekti i sheshit është duke përfunduar në Krushë të Madhe dhe pritet që shumë shpejt të finalizohet. 4.Planifikim për vitin 2024
	1. Kubëzimi i disa rrugëve	Afrim Krasniqi- Pastasel	1. I pranuar	

	2. Mungesë e ndriçimit në disa lagje 3. Vazhdimi i kanalizimit (dy pjesë) 800m i mbyllur		2.I pranuar 3. I pranuar	1. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023, është I kontraktuar disa segmente rrugore ne Pastasel dhe pritet gjate fillim vitit 2023 të fillojnë punimet 2. Nje pjesë e ndriçimit ka filluar të implementohet dhe gjatë vitit 2022 pritet t'i mbulojmë komplet vendbanimet 3. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023.
	1. Rregullimi i kanalit të kullimit te perfundoj ne vitin 2022 2. Shkolla të përfshihet ne programin e Eficences	Xhafer Gashi-Sopniq	1. I pranuar pjesërisht 2. I pranuar pjesërisht	1. Kontrata është e lidhur dhe pritet implementimi i plotë i projektit. 2. Do të investohet në bashkëpunim me fondin për eficiencë energjetike dhe të bëhet përpjekje që edhe shkolla në Sopniq të futet.
	1. Rregullimi i rrugës Ratkoc-Vrajak-Brotatin e demtuar	Bajram Morina-Ratkoc	1. I pranuar	1. Do të intervenohet në vitin 2023
	1. Rregullimi i rrugicave me kubëza a ka diçka për këtë projekt 2. Shkolla të përfshihet ne programin e Eficiencës	Enver Kabashi Zoqisht	1. I pranuar 2. I pranuar pjesërisht	1. Jane te kontraktuara rrugicat për kubëzim ne fshatin Zoqisht 2. Do të investohet në bashkëpunim me fondin për eficiencë energjetike dhe të bëhet përpjekje që edhe shkolla në Zoqisht të futet.

3. Vazhdimi i lumit deri te ura e Retisë për shkak të problemeve me vërshime		3. I pranuar	3. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
1. Munges të kanalizimit ne disa lagje të fshatit a ka diçka për vitin 2022	Muhamet Ramadani-Celine	1. I pranuar	1. Disa lagje janë përfunduar në vitin 2022. Të gjitha kërkesat tjera që lidhen me zgjerimin e kanalizimit do të përfshihen në buxhetin e vitit 2023
1. Sheshi i Rahovecit a do të fillojnë punimet 2022-2023 a është planifikuar për vitin 2023	Hajredin Kadiri- Rahovec	1. I pranuar	1. Jemi në fazën e vlerësimit të ofertave dhe memomentin që do të përfundojnë të gjitha procedurat, do të fillojmë me punimet
1. Vazhdimi i rregullimit të rrugëve me kubeza	Beqë Shala- Ratkoc	1. I pranuar	1. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023. Është kontrata e lidhur dhe pritët te ekzekutohet
2. Zgjerimi i kanalizimeve ne disa lagje		2. I pranuar	2. Kemi pasur intervenime dhe nese ka nevojë prapë do të intervenojmë
3. Zgjerimi i ndriqimit publikë		3. I pranuar	3. Ka pasur investime ne ndriçim publik por nëse ka kërkesa do të vazhdojmë edhe me disa lagje tjera
4. Vazhdimi i perkrahjes se fermereve me mekanizma bujqesor		4. I pranuar	4. Do të përkrahen siç janë përkrahur vazhdimisht

	1. Ndërtimi i shkolles fillore ne Xërxe 2. Rrezik në hyrje dhe dalje te shkolles 3. Te mirmbahen rrethojat e shkolles 4. Rruga për Ratkoc (sinjalizimi)	Fadil Bytyqi <i>Xërxe</i>	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	1.Fillimi brenda vitit 2022. Është shpallur procedura për ndërtimin e shkollës së re 2. Përveç që është rrugë rajonale, Komuna do të vazhdoj me projektin e zgjerimit me rrugën 4 korsi Rahovec Xerxe 3. Në kuadër të planifikimit që ka drejtoria e Arsimit për mirëmbajtje të oborreve shkollore do të bëhet edhe mirëmbajtja e rrethojës së shkollës 4. Rruga që lidh Xërren dhe Ratkocin është e sinjalizuar ndërsa rrugët tjera që kanë mbetur pa sinjalizim Komuna do të bëj përpjekje që të vazhdoj me projektin e sinjalizimit
	1. Intervenime ne kanalizim 2. Rregullimi i fushes se sportit ne oborrin e shkolles 3. Vazhdimi i kodit per festivalin (Anadrinia Jehon) zhveshtore	Muharrem Morina-Dejnë	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar	1. Gjatë 2023 do të trajtohen të gjitha problemet që lidhen me zgjerimin e rrjetit të ujërave të zeza në ato vende ku është mëse e nevojshme 2. Drejtoria e Arsimit ka krijuar disa parklingje në këtë lokalitet poashtu gjatë 2023 në project buxhetin që ka kjo drejtori do të planifikoj rregullimin e fushës sportive në shkollën e Dejnës 3. Çdo vit Komuna e Rahovecit mbeshtet e mjete vetanake festivalin Anadrinia Jehon

				përveç kësaj Komuna e Rahovecit ka krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për mbajtjen e festivalit duke përfshirë tribunat dhe pjesët tjera të nevojshme
1. Sanimi dhe riparimi i rrugëve egzistuese në fshat			1. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit ka kontratë për sanimin dhe riparimin e rrugëve, disa rrugë janë rregulluar sivjet dhe pritet edhe rrugë të tjera që kanë nevojë të trajtohen
2. Rregullimi i kanalizimit në lagjen e epërme				2. Në tri lagje të fshatit Xërxe, Komuna e Rahovecit ka bërë investime në rrjetin e ujërave fekale poashtu në 2023 do të vazhdojë ky projekt sipas nevojave dhe kërkesave të qytetarëve
3. Gjetja e një parcele prone e komunes për komunitetin e fshatit (varreza)			2. I pranuar	3. Drejtoria për Gjeodezi do të interesohet për gjetjen e një parcele prone publike në qoftëse do të ketë vendim të Kuvendit komunal
4. Të zgjerohet ngriqimi public në disa lagje	Artan Thaçi- Xërxe		3. I pranuar pjesërisht	4. Shumica e vendbanimit në fshatin Xërxe është e mbuluar me ndriçim publik dhe gjatë vitit 2022 do të mbulohet tërësisht
5. Të ndertohet një fushe ndihmese rekreative për fëmijë			4. I pranuar	5. Të gjendet lokacioni prone publike dhe më pas ne do të
6. Shtrimi dhe mirembajtja e rrugëve fushore (2km)			5. I pranuar pjesërisht	
7. Përfundimi i punimeve në parkun e			6. I pranuar	

	fshatit ne rrugen (Skenderbeu)		7. I pranuar	bëjmë për futjen në buxhet në vitin 2024
			8. I pranuar	6. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023 7. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
	1. Rregullimi i kanalizimit për ujëra të zeza, për te e zgjidhur kete problem duhet te behet lidhja e rrjetit te kanalizimit te vjeter me rrjetin e kanalizim te ri ku është nje gjatesi rreth 400 metra. 2. Rregullimi i kanaleve per ujra atmosferik Brenda ne fshat me gjatesi rreth 750 metra dhe rregullimi nje kanali te kullimit prej hekurudhes deri ne lumen drini I bardhe me gjatesi rreh 1 km	Kujtim Sopjani- Dobidol	1. I pranuar 2. I pranuar pjesërisht	1. Kanalizmi në fshatin Dobidol 2022 ka qenë i trajtuar me së miri në gjatësi prej 3 km, sipas nevojave në vitin 2023 do të shohim mundësinë edhe për trajtimin e atyre lagjeve që kanë nevojë 2. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023

	3. Shkolla fillore ne fshatin Dobidol : Rregullimi i rrethojes, oborrit dhe rregullimi i nje fushe te futbollit per nxenes te Shkolles		3. I pranuar	3. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
	4. Kubezimi i rrugeve ne fshat me gjatesi rreth 1 km		4. I pranuar	
	5. Riparimi i troturareve dhe vazhdimi me kubza deri ne sarosh, me gjatesi rreth 1 km		5. I pranuar	4. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
	6. Rregullimi i rrugeve fushore		6. I pranuar	5. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
	7. Rregullim i nje shteku per ecje ne gjatesi rreth 2 km		7. I pranuar pjesërisht	6. I planifikuar në buxhetin e vitit 2023
	8. Menaxhimi i mbeturinave			7. I planifikuar në buxhetin e vitit 2024
	9. Rregullim i shtratit te		8. I pranuar	

	lumit drini i bardhe		9. I pranuar	8. Cdo vit Komuna e Rahovecit e ben pastrimin e deponive ilegale. 9. I planifikuar të përfundohet me ndihmën e donatorëve
	1. Uji i pijes Drenoc-Senoc	Artan Asllani-Drenoc	1. I pranuar pjesërisht	1.Në bashkëpunim me KRU "Gjakova" do të planifikohet.

Rahovec,; 14.9.2022

Grupi Punues



Ekrem Bytyqi

Kryesues i Grupit